

UPCOMING EVENTS | IMPORTANT DATES

June 07 - Member's Assembly

June 13 - Infosession about Regional Challenge Fund

June 15 - National Fair for Work, Career and Entrepreneurship

June 20 - Workshop for ChatGPT

June 22 - Infosession about trade fairs in Germany in collaboration with KIESA

DIRECTOR'S NOTE

Të nderuar anëtarë,

Javën që e kemi lënë pas ka pasur një ritëm të lartë dhe një pjesëmarrje të gjerë të Odës Ekonomike Gjermano-Kosovare në ngjarje të rëndësishme, përfshirë edhe ngjarjet e rëndësishme të cilat i kemi organizuar vet si odë.

Ngjarja kryesore ka qenë prezantimi i rezultateve vjetore të Anketës AHK Konjunkturumfrage, që u organizua si event në rezidencë të ambasadorit gjerman në Kosovë, Jörn Rohde. Përveç ambasadorit, në këtë prezantim mori pjesë kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, kryetari i Bordit të OEGJK-së, Besnik Beqiri dhe drejtoresha ekzekutive e OEGJK-së, Nora Hasani.

Anketa e realizuar mes datave 13 Shkurt dhe 17 Mars 2023, krahason ekonomitë e 16 shteteve, dhe ofron njohuri të vlefshme për situatën ekonomike, klimën investuese dhe perspektivat e biznesit në Kosovë, si dhe shërben si mjet thelbësor në vlerësimin e klimës ekonomike në Kosovë. Në anketë morën pjesë 1.620 CEO në 16 shtete, prej të cilave 103 ishin nga kompanitë kosovare me fokus në kompanitë gjermane dhe biznese të orientuara nga eksporti. Gjetjet theksojnë qëndrueshmërinë e ekonomisë së Kosovës përkundër sfidave të jashtme.

Aty pati edhe diskutim mes bizneseve anëtare Premium të odës të cilat ishin mysafire dhe

Dear members,

The past week has been marked by a high pace and broad participation of the German-Kosovar Economic Chamber in important events, including those organized by our chamber itself.

The main event was the presentation of the annual results of the AHK Konjunkturumfrage survey, which took place as an event at the residence of the German Ambassador to Kosovo, Jörn Rohde. In addition to the ambassador, this presentation was attended by the Prime Minister of Kosovo, Albin Kurti, the Chairman of the Board of OEGJK, Besnik Beqiri, and the Executive Director of OEGJK, Nora Hasani.

The survey conducted between February 13 and March 17, 2023, compares the economies of 16 countries and provides valuable insights into the economic situation, investment climate, and business prospects in Kosovo. It serves as a crucial tool in assessing the economic climate in Kosovo. The survey included 1,620 CEOs from 16 countries, of which 103 were from Kosovar companies focused on German companies and export-oriented businesses. The findings emphasize the resilience of Kosovo's economy despite external challenges.

During the event, there was also a discussion among the Premium member businesses of the chamber, who were guests, as well as leaders

udhëheqësve të institucioneve lokale e ndërkombëtare dhe atyre qeveritare.

from local, international, and governmental institutions.

Rezultatet e plota të anketës mund t'i gjeni në këtë link: <https://shorturl.at/xFGX6>

You can find the complete survey results at this link: <https://shorturl.at/xFGX6>



Nën organizim të Odës ishte edhe tryeza e diskutimit për të drejtat e pronësisë industriale dhe intelektuale, ku folës kryesorë ishin Isa Dukajn, U.D. në Agjencinë për Pronësi Industriale në MINT dhe Zjarra Osmanin, U.D. Drejtorë e Zyrës për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta në MKRS.

Under the organization of the chamber, there was also a panel discussion on Industrial and Intellectual Property Rights, featuring keynote speakers Isa Dukajn, Deputy Director at the Industrial Property Agency in MINT, and Zjarra Osmanin, Deputy Director of the Office for Copyright and Related Rights in MKRS.

Gjatë takimit u diskutuan një sërë çështjesh, nga anëtarësimi në organizata ndërkombëtare, korniza legjislative, fushatat promovuese me theks të veçantë tek të drejtat e autorit, e deri tek temat si funksionimi i mekanizmave të cilët mbikqyrin zbatimin e të drejtave të pronësisë industriale dhe intelektuale në terren.

During the meeting, a range of issues were discussed, including membership in international organizations, legislative frameworks, promotional campaigns focusing particularly on Copyrights, and topics such as the functioning of mechanisms overseeing the implementation of industrial and intellectual property rights on the ground.

Pjesë e këtij diskutimi, duke marrë përgjigje konkrete në pikëpyetjet e tyre ishin kompanitë anëtare si: StoneCastle, Vokshi&Lata, Union Sh.P.K., KosovaPlast-B, BKIP Consulting dhe SCLR Partners.

Participating in this discussion, with specific answers to their queries, were member companies such as Stonecastle, Vokshi&Lata, Union Sh.P.K., KosovaPlast-B, BKIP Consulting, and SCLR Partners.

Drejtoresha ekzekutive e OEGJK-së, Nora Hasani, ka mbajtur takime të shumta, të cilat janë të lidhura me organizimin e Forumit Ekonomik Gjermano-Kosovare, i cili vjen në muajin shtator këtë vit. Gjithashtu, ajo mbajti edhe një ligjeratë tek "Spring School for Junior Diplomats for Fireside Chat", ku foli për integrimin ekonomik dhe biznesor të Kosovës në Europë.

Ekipi tjetër i Odës Ekonomike Gjermano-Kosovare ka marrë pjesë në dy evente shumë të rëndësishme, siç ka qenë konferencën para ofertuese për Ankandin Solar 100 MW, organizuar në bashkëpunim me USAID-in, pasi tashmë pothuajse gjithçka është gati të shpallet ankandi për këtë kapacitet të instalimit dhe me lokacion në Kramovik të Rahovecit.

Edhe KSDW - KOSOVO SUSTAINABLE DEVELOPMENT WEEK (Java e Zhvillimit të Qëndrueshëm në Kosovë) ka nisur në këtë javë dhe OEGJK ka qenë pjesëmarrëse në hapje dhe disa prej paneleve të diskutimit.

Java në vijim do të jetë e mbushur me aktivitete, të cilat ju ftojmë t'i ndiqni në rrjetet tona sociale, mirëpo edhe nëpërmes njoftimeve të cilat ua dërgojmë në e-mail.

Faleminderit!

The Executive Director of OEGJK, Nora Hasani, has held numerous meetings related to the organization of the German-Kosovar Economic Forum, which will take place in September this year. Additionally, she delivered a lecture at the Spring School for Junior Diplomats for Fireside Chat, where she spoke about Kosovo's economic and business integration into Europe.

Another team from the German-Kosovar Economic Chamber participated in two highly important events. One of them was the pre-offer conference for the Solar 100 MW Tender, organized in collaboration with USAID, as the bidding process for this installation capacity, located in Kramovik, Rahovec, is almost ready to be announced.

Furthermore, the Kosovo Sustainable Development Week (KSDW) has started this week, and OEGJK has been a participant in the opening ceremony and several discussion panels.


The upcoming week will be filled with activities, which we invite you to follow on our social media networks, as well as through the notifications sent to your email.

Thank you!

↓ **PHOTOS AND MORE INFO BELOW** ↓

OUR WEEK IN PICTURES





YOUR CONTACT PERSONS AT KDWV



Znj. Sytrime Dervisholli,
Udhëheqëse e departamentit
për marrëdhënie me qeverinë
dhe avokim mund ta
kontaktoni në:

sytrime.dervisholli@oegjk.org

Sytrime Dervisholli, Head of
the Department for
Government Relations and
Advocacy can be contacted
at:

sytrime.dervisholli@oegjk.org

Ekipi i znj. Dervisholli nuk është vetëm përgjegjës për përfaqësimin e interesave të anëtarëve, por gjithashtu koordinon gjashtë grupet punuese të OEGJK-së, dhe punon në publikimet tona, si dhe në raportet sektoriale:

[Publikimet e OEGJK-së](#)

The team of Ms. Dervisholli is not only responsible for representing the interests of KDWV-members, but also coordinates the six working groups of KDWV, and works on our publications, as well as on sector reports:

[Publications](#)



Udhëheqëse e
departamentit për
mbështetjen dhe
shërbimet e anëtarëve
është znj. Besarta
Hyseni:

besarta.hyseni@oegjk.org

Head of Market Entry and
Events is:

besarta.hyseni@oegjk.org

Ekipi i znj. Hyseni jo vetëm që mbështet anëtarët me eksport, këshilla ligjore (kemi këshilltarë ligjorë në ekip), këshilla për Joint Venture, Franchise dhe Senior Expert Service, por gjithashtu organizon takime B2B, udhëtime delegacioni, punëtori dhe ngjarje informuese për anëtarët.

The team of Ms. Hyseni not only supports members regarding export, legal advisory services (KDWV has inhouse lawyers), Joint Venture, Franchise and Senior Expert Service, but also organizes B2B meetings, delegation trips, workshops, and info-sessions for members.



Për çështje financiare (pagesa
e anëtarësimit/faturat etj.)
mund ta kontaktoni znj. Greta
Kazia:

greta.kazia@oegjk.org

For financial matters
(membership fees/invoices,
etc.) please contact Ms. Greta
Kazia:

greta.kazia@oegjk.org



Për këshillim ligjor të
investitorëve gjerman dhe
anëtarëve të OEGJK mund
ta kontaktoni znj. Gonxhe
Abazi:

gonxhe.abazi@oegjk.org

For legal advice to German
Investors and members of
KDWV please contact Ms.
Gonxhe Abazi:

gonxhe.abazi@oegjk.org

BOOK YOUR APPOINTMENT AT KDWV-OEGJK:

ICON Tower, 9th Floor, Rr. Bekim Fehmiu 110; 10000 Prishtina

Monday - Friday | 8.30 - 16.30